

PROFILET PROFESIONALE

*INFERMIERI
MAMI
FIZIOTERAPI
LOGOPEDI
TEKNIK - IMAZHERIE
TEKNIK - LABORATORI
TEKNIK LABORANT DENTAR*

Tiranë, 2023

Përmbajtja

Hyrje

1. Njohja e figurës profesionale të Infermierit në Republikën e Shqipërisë .
2. Njohja e figurës profesionale të Mamisë në Republikën e Shqipërisë .
3. Njohja e figurës profesionale të Fizioterapistit në Republikën e Shqipërisë .
4. Njohja e figurës profesionale të Logopedit në Republikën e Shqipërisë .
5. Njohja e figurës profesionale të Teknikut të Imazherisë në Republikën e Shqipërisë .
6. Njohja e figurës profesionale të Teknikut të Labororit në Republikën e Shqipërisë .
7. Njohja e figurës profesionale të Teknikut të Labororit Dentar në Republikën

Hyrje

Profesionet e shëndetësisë janë profesione të rregulluara dhe si të tilla i nënshtrohen një sërë rregullash juridike, jo vetëm kombëtare por dhe komunitare. Vitet e fundit, shumë vende të Bashkimit Europian (BE) dhe jo vetëm, kanë zhvilluar një reformë të thellë në profilet e profesioneve të shëndetësisë, në profilin e shkencave infermiere, në profesionin e mamisë, të teknikeve, të rehabilitimit dhe parandalimit. Këto ndërhyrje kanë qenë të domosdoshme si për zhvillimin shkencor dhe teknologjik të sistemeve shëndetësore kombëtare, ashtu edhe të nevojave të reja shëndetësore ndaj të cilave u nënshtrohet popullata botërore, duke përfshirë edhe sistemin shëndetësor kombëtar shqiptar në aspekte të ndryshme. Në fakt, kjo reformë buron edhe nga orientimet dhe rekomandimet e Këshillit të Europës për këtë temë dhe miratimit që tashmë i kanë bërë vendet anëtare të BE-së por edhe shtetet joeuropiane, të cilat janë në këtë evolucion të profileve të profesionistëve të kujdesit shëndetësor prej vitesh me qasje pozitive për shëndetin e qytetarëve.

Në Shqipëri profesionet shëndetëore gjejnë një rregullim në ligjin për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë, në ligjin për Urdhrin e Infermierit të Shqipërisë (UISH), por ka një vakancë të normave për sa i përket profileve dhe kompetencave të këtyre profesionistëve.

UISH po punon vazhdimisht për të rritur profesionalisht figurën e infermierit dhe të gjitha profesioneve anëtarë të tij, prej disa muajsh në bashkëpunim me profesionistë të fushës, shoqërinë civile dhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) ka përpunuar profilet profesionale shëndetësore, reabilituese dhe teknike të:

- 1) Infermierisë
- 2) Mamisë
- 3) Fizioterapeftit
- 4) Logopedisë
- 5) Teknik Imazherie
- 6) Teknik Laboratori
- 7) Teknik Laboratori Dentar

UISH, si promotor i kësaj reforme, është i vetëdijshëm se këto profesione shëndetësore janë ende në një proces zhvillimi akademik. Njëkohësisht legjislacioni ynë aktual ka nevojë për ndryshime, ai është i papërshtatshëm apo ende i parregulluar po të krahasohet me modelet

e avancuara dhe funksionale të

shteteve të tjera të BE- së, si dhe me evolucionin legjislativ, shkencor dhe teknologjik me të cilën shëndetësia shqiptare do të përballet në të ardhmen e afërt.

Reformimi i profesioneve shëndetësore është një pikë kryesore dhe vendimtare e UISH-së, sepse vendosja në qendër e kësaj nisme, qoftë edhe në një marrëveshje fillestare, mund të arrihet vetëm përmes marrëdhënies së drejtpërdrejtë me MSHMS duke siguruar:

- Miratimin e profileve profesionale të profesionistëve të shëndetësisë dhe profileve të reja.
- Adoptimin e metodave të reja organizative ku në qendër nuk është figura e mjekut.
- Miratimin e kompetencave profesionale.

Vizioni ynë synon të ndërtojë një kuadër profesional për profesionistët e shëndetësisë shqiptare, profesione të karakterizuara dhe të përcaktuara në drejtim të menaxhimit, të dominimit, të menaxhimit të tregut dhe të shërbimeve, si në fushën klinike ashtu edhe në atë administrative, duke përcaktuar të ardhmen e kompetencave bazë sipas specialiteteve dhe atyre të avancuara të profesionistëve të shëndetësisë.

Për sa u citua më sipër, del në pah se rritja dhe fuqizimi i përgjegjësive, njëkohësisht i rolit të profesioneve të shkencave teknike shëndetësore duhet të përcaktohet nga veprimtaria e punës, legjislative dhe administrative, të cilat duhet të realizohen në respekt të plotë dhe në përputhje me kompetencat profesionale, të cilat identifikohen me ndërhyrje direkte në parandalimin, kujdesin dhe mbrojtjen e shëndetit individual dhe kolektiv.

Nisur nga zhvillimet e reja në fushën e arsimit të lartë ku tashmë kolegjet profesionale ofrojnë programe studimi dy vjeçar për profilin e Teknikut të Laboratorit Dentar, gjithashtu nga nevoja që kanë strukturat tona shëndetësore publike dhe jo publike për figura të tilla, thellësisht teknike, të cilat i vijnë në ndihmë profesioneve si infermier, mjek dhe mjek stomatolog UISH e sheh si domosdoshëmri përfshirjen në rregullimet e profileve profesionale edhe të këtij profesioni.

Përcaktimi i profileve të profesioneve të shkencave teknike në Shqipëri së bashku me ligjet e tjera.

Falenderojmë grupin e punës në përpunimin e materialit:

Profesioni i infermierisë:

Phd Cand Blerina DUKA
Msc Irena LASKA
Phd Cand Sajmira ADERAJ
Msc Mirva HOXHA
Msc Erind THARTORI
Msc Hëna DUMI

Profesioni i Mamisë:

Msc Delantina MULLA
Msc Shpresa MOLLA
Msc Vjollca QATIPI
Msc Flutura IBRAHIMI
Msc Anjeza KOLANECI

Profesioni i Fizioterapisë:

Phd Can Alta ARAPI
Phd Sidita HAXHOLLI
Phd Aisel OSEKU
Msc Roxhensa SULA
Phd Cand Florian SPADA
Phd Cand Emanuela PRENDI

Profesioni i Logopedisë

Msc Mei BITRI
Msc Gjergji DOKO
Msc Enid RUÇI
Msc Berjana MOLLA

Profesioni i Teknik Imazherisë

Phd Cand Elona DYBELI
Msc Fluturim NELA
Msc Erjola ZOGAJ
Msc Gerta HALILI
Phd Harris MEMA

Profesioni i Teknik Laboratorit:

Msc Marsela LUTO
Msc Suela GJEÇI
Msc Emirela CENOMERI

Profesioni i Laborantit Dentar:

Msc Hysen DIBRA
Msc Erjon SALIAJ
Msc Vilma ZOJA

Profili profesional i Infermierit në Republikën e Shqipërisë

Me qëllimin për të garantuar mbrojtje të shëndetit të popullatës, domosdoshmërinë e edukimit në vazhdim, si dhe dhënien e një shërbimi me standarte për mbrojtjen e shëndetit të popullatës në përgjithësi figura profesionale e infermierit identifikoh

Infermieri është punonjësi shëndetësor i cili disponon diplomën e nivelit të parë të studimeve (Bachelor); ka kaluar me sukses Provimin et me profilin e mëposhtëm:

1. Infermieri është punonjësi shëndetësor i cili disponon diplomën e nivelit të parë të studimeve (Bachelor); ka kaluar me sukses Provimin e Shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe është i pajisur me Leje të ushtrimit të profesionit nga Urdhri përkatës profesional duke qenë pjesë e regjistrit të anëtarësisë.
2. Infermieri është përgjegjës për dhënien e kujdesit infermior parandalues, vendos diagnozën infermiore, ka rol edukues, trajtues, rehabilitues dhe ofron trajtim paliativ për pacientët me sëmundje të avancuar në fazat terminale. Funkcionet kryesore janë promovimi i jetës së shëndetshme, parandalimi i sëmundjeve , edukimi shëndetësor dhe terapeutik , kujdesi për të sëmurët dhe invalidët e të gjitha moshave, menaxhimi, formimi dhe kërkimi shkencor. Infermieri asiston, trajton dhe ofron kujdes ndaj pacientit në mënyrë globale dhe duke vendosur me të një marrdhënie besimi.
3. Infermieri duhet të ketë:
 - a. njohurishkencore brenda fushës së infermierisë;
 - b. njohuri për anatominë, funksionet fiziologjike, sjelljen/qasjen ndaj individëve të shëndetshëm dhe atyre të sëmurë; marrëdhëniet midis gjëndjes shëndetësore dhe mjedisit fizik e atij social tënjeriut;
 - c. njohuri për natyrën e profesionit, parimet e Etikës dhe Deontologjisë si çështje të rëndësishme në punën e përditshme dhe që kanë lidhje me mbrojtjen e shëndetit dhe ofrimin e shërbimit shëndetësor përkatës;
 - d. të zbatojë parimin e mosdiskriminimit si dhe të ruajë konfidencialitetin.
 - e. të ruajë sekretin mjekësor;
 - f. përvojë klinike ; Një përvojë e tillë duhet të fitohet nëpërmjet praktikës, edukimit në vazhdim dhe mbikëqyrjes nga personeli kompetent i kualifikuar dhe me përvojë, në vendet ku numri i personelit dhe i pajisjeve është i përshtatshëm për kujdesin infermior ndaj pacientëve, qofshinkëto diagnostikuese apo terapeutike;

- g. aftësi për të bashkëpunuar me ekipin multidisiplinar, në lidhje me trajnimin praktik të studentëve.
4. Në përputhje me ekspertizën e tij, infermieri duhet të jetë në gjendje të zbatojë aftësitë e mëposhtme:
- a. të ofrojë diagnostikimin në mënyrë të pavarur në kujdesin infermieror të kërkuar duke përdorur njohuritë teorike dhe klinike, si dhe të planifikoj, të identifikoj, të organizoj dhe të zbatoj ndërhyrjet e kujdesit infermieror në trajtimin e pacientëve, bazuar në njohuritë, aftësitë profesionale dhe praktikën e bazuar në prova; të parashikuara në pikat (a), (b) dhe (c) të pikës 3 të mësipërme;
 - b. të garantoj një aplikim korrekt të përshkrimeve diagnostiko-terapeutike që janë në kartelën mjekësore të pacientit;
 - c. të punojë në mënyrë efektive me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor, duke bashkëpunuar me ta dhe duke i përfshirë në trajnime praktike rreth kujdesit, bazuar tek njohuritë dhe aftësitë e mësuara dhe ato të fituara, në përputhje me paragrafët (d) dhe (e) të pikës 3 të mësipërme;
 - d. të fuqizojë individët, familjet dhe komunitetin, duke i ndihmuar ata në përvetësimin e stileve të shëndetshme të jetesës dhe aftësive të vetëkujdesit, bazuar në njohuritë dhe aftësitë e fituara sipasparagrafëve (a) dhe (b) të pikës 3;
 - e. të fillojë ndërhyrjet e menjëhershme për të ruajtur jetën në situata emergjente apo katastrofe;
 - f. të këshillojë, edukojë dhe mbështesi individët që kanë nevojë për ndihmë dhe për familjet e tyre;
 - g. të garantojë dhe vlerësojë në mënyrë të pavarur cilësinë e kujdesit infermieror;
 - h. të komunikojë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe profesionale duke bashkëpunuar me profesionistët tjerë të kujdesit shëndetësor;
 - i. të vlerësojë cilësinë e kujdesit të ofruar për të përmirësuar praktikën e tyre profesionale si infermier të përgjithshëm.
5. Infermieri kontribuon në trajnimin e stafit mbështetës duke ndikuar drejtpërdrejtë në përditësimin e profilit të tyre profesional dhe kërkimit shkencor.
6. Formimi akademik infermieror me titullin “Infermier i Përgjithshëm”, synon të sigurojë njohuri profesionale dhe klinike për të mundësuar ofrimin e shërbimeve infermiore në fushat e mëposhtme:
- a. Shëndeti Publik: Infermier i Shëndetit Publik në kujdesin parësor .
 - b. Emergjencë/urgjenca: Infermier urgjence.
 - c. Pediatri: Infermier pediatrie dhe neonatologjie.
 - d. Patologji: Infermier patolog.
 - e. Terapia Intensive: Infermier iterapisë intensive.
 - f. Kirurgji: Infermieri kirurgjikale.
 - g. Shëndet Mendor-Psikiatri: Infermier në shëndetin mendor dhe psikiatri.
 - h. Geriatri: Infermier në geriatri.
 - i. Kujdesipaliativ: Infermier në kujdesin paliativ.

7. Infermieri ushtron veprimtarinë e tij profesionale në strukturat shëndetësore publike ose jo-publike.

Profili profesional i Mamisë në Republikën e Shqipërisë

Me qëllimin për të garantuar mbrojtje prioritare shëndetit të gruas shtatzënë, mirëqenies së familjes dhe gjithë shoqërisë, për të ofruar shërbimin në standarte, domosdoshmërinë e edukimit në vazhdim dhe trajnime figura profesionale e mamisë identifikohet me profilin e mëposhtëm:

1. Mamia është punonjësi shëndetësor i cili disponon diplomën e nivelin e parë të studimeve (Bachelor), ka kaluar me sukses Provimin e Shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe është i pajisur me Leje të ushtrimit të profesionit nga Urdhri përkatës profesional duke qenë pjesë e regjistrit të anëtarësisë.
2. Mamia ndjek dhe këshillon gruan gjatë shtatzënisë, gjatë lindjes dhe në puerperium, drejton sallën e lindjes, ndjek me përgjegjësi lindjet dhe iofron ndihmë të porsalindurit.
3. Mamia duhet të ketë:
 - a. njohurishkencore mjekësore brenda fushës së obstretikës;
 - b. njohuri për anatominë, funksionet fiziologjike, sjelljen/qasjen e individëve të shëndetshëm dhe atyre të sëmurë , marrëdhëniet midis gjendjes shëndetësore të gruas dhe bebit, mjedisit fizik dhe atij social;
 - c. njohuri për natyrën e profesionit, etikën në punë dhe parimet e përgjithshme të cilat kanë lidhje me mbrojtjen e shëndetit dhe ofrimin e shërbimit mjekësor përkatës; të mbështetet në parimin e mosdiskriminimit si dhe mbrojtjen e konfidencialitetit. Të ruajë sekretin mjekësor;
 - d. përvojë klinike ; Një përvojë e tillë duhet të fitohet nëpërmjet praktikës, edukimit në vazhdim dhe mbikëqyrjes nga personeli kompetent i kualifikuar dhe me përvojë në vendet ku numri i personelit dhe i pajisjeve është i përshtatshëm për kujdesin obstretikë ndaj pacientëve, qofshin këto diagnostikuese apo terapeutike;
 - e. aftësi për të bashkëpunuar me ekipin multidisiplinar, në lidhje me trajnimin praktik të studentëve.
4. Në përputhje me ekspertizën mamia duhet të jetë në gjendje të paktën të zbatojë aftësitë e mëposhtme:
 - a. të ofrojë në mënyrë të pavarur kujdesin obstretikë të kërkuar duke përdorur njohuritë teorike dhe klinike, të planifikojë, organizojë dhe zbatojë ndërhyrje obstetrike në trajtimin e pacientëve, bazuar në njohuritë dhe aftësitë e parashikuara në paragrafët (a), (b) dhe (c) të pikës 3;

- b.** të punojë në mënyrë efektive me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor, duke i përfshirë ata në trajnime praktike dhe duke u bazuar tek njohuritë dhe aftësitë e fituara në përputhje me paragrafët (d) dhe (e) të pikës 3;
 - c.** të fuqizojë individëvet, familjet dhe grupet duke i ndihmur në përvetësimin e stileve të shëndetshme të jetesës dhe aftësive të vetëkujdesit, bazuar në njohuritë dhe aftësitë e fituara sipas paragrafëve (a) dhe (b) të pikës 3;
 - d.** të fillojë ndërhyrjet e menjëhershme për të ruajtur jetën e gruas dhe bebit në situata krize apo katastrofe; të ofrojë këshilla rreth kujdesit shëndetësor dhe edukatës seksuale në familje dhe komunitet;
 - e.** Të komunikojë në mënyrë gjithëpërfshirëse, bashkëpunuese dhe profesionale me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor;
 - f.** Të kontrollojë cilësinë e kujdesit të ofruar për të përmirësuar praktikën e tyre profesionale si mami dhe ofrimin e kujdesit obstetrik në përgjithësi;
 - g.** Të marrë pjesë në; përgatitjen psikoprofilaktike për lindjen, përgatitjen dhe asistencën për ndërhyrje gjinekologjike, parandalimin dhe vlerësimin e tumoreve të sferës gjinekologjike dhe programet e asistencës së nënës dhe neonatit.
- 5.** Mamia në zbatim të etikës profesionale dhe brenda kompetencës, drejton si anëtare e ekipit shëndetësor ndërhyrjet ndihmëse.
 - 6.** Mamia kontribuon në trajnimin e stafit mbështetës duke ndikuar drejtpërdrejtë në përditësimin e profilit të tyre profesional dhe kërkimit shkencor
 - 7.** Mamia është në gjendje të identifikojë situata potencialisht patologjike të cilat kërkojnë ndërhyrje mjekësore dhe praktikon kur është e nevojshme masat e veçanta të urgjencës.
 - 8.** Mamia ushtron veprimtarinë e saj/tij profesionale në strukturat shëndetësore publike ose jo-publike.

Profili profesional i Fizioterapeftit në Republikën e Shqipërisë

Me qëllimin për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe dhënien e një shërbimi cilësor dhe të mbështetur në standarte, domodoshmërinë e edukimit në vazhdim dhe trajnimeve figura e fizioterapeftit identifikohet me profilin e mëposhtëm:

1. Fizioterapefti është punonjësi shëndetësor i cili disponon diplomën e nivelin e parë të (Bachelor), ka kaluar me sukses Provimin e Shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën Shqipërie si dhe është i pajisur me Leje të ushtrimit të profesionit nga Urdhri përkatës profesional duke qenë pjesë e regjistrit të anëtarësisë.
2. Fizioterapefti realizon në mënyrë autonome ose në bashkëpunim me profesionistë të tjerë të shëndetit ndërhyrjet e parandalimit, trajtimit dhe rehabilitimit të aftësive motorike, funksioneve kortikale superiore dhe atyre viscerale që vijnë nga ngjarje patologjike, të etiologjive të ndryshme, të lindura ose të fituara.
3. Në përfundim të studimeve të nivelit bachelor Fizioterapefti duhet të ketë fituar njohuritë dhe aftësitë e mëposhtme:
 - a. njohuri shkencore mjekësore brënda fushës së fizioterapisë;
 - b. njohuri për anatominë, funksionet fiziologjike, sjelljen/qasjen e individëve të shëndetshëm dhe atyre të sëmurë , marrëdhëniet midis gjëndjes shëndetësore, mjedisit fizik dhe atij social të njeriut;
 - c. njohuri për natyrën e profesionit, etikën në punë dhe parimet e përgjithshme të cilat kanë lidhje me mbrojtjen e shëndetit dhe ofrimin e shërbimit mjekësor përkatës;
 - d. të mbështetet në parimin e mosdiskriminimit si dhe mbrojtjen e konfidencialitetit;
 - e. të ruajë sekretin mjekësor;
 - f. përvojë klinike ; Një përvojë e tillë duhet të fitohet nëpërmjet edukimit në vazhdim dhe mbikëqyrjes nga personeli kompetent i kualifikuar dhe me përvojë në vendet ku janë të instaluar pajisjet e nevojshme për realizimin e ekzaminimeve fizioterapeutike, qofshinkëto diagnostikuese apo terapeutike;
 - g. aftësi për të bashkëpunuar me ekipin multidisiplinar, në lidhje me trajnimin praktik të studentëve.
4. Në përputhje me ekspertizën e tij, Fizioterapefti duhet të jetë në gjendje të zbatojë të paktën aftësitë e mëposhtme:

- a. të menaxhojë në mënyrë të pavarur terapinë fizioterapeutike të përshkruar nga mjeku specialist i kërkuar, duke përdorur njohuritë teorike dhe klinike;
 - b. të planifikojë, organizojë dhe zbatojë ndërhyrjet fizioterapeutike në trajtimin e pacientëve, bazuar në njohuritë dhe aftësitë e parashikuara në paragrafët (a), (b) dhe (c) të pikës 3, me qëllim përmirësimin e praktikës profesionale;
 - c. të punojë në mënyrë efektive me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor për trajnimin praktik të tyre, duke përdorur njohuritë bazë dhe aftësitë e fituara në përputhje me shkronjat (d) dhe (e) të pikës 3;
 - d. të ndihmojë individët, familjet dhe grupet e komunitetit në përvetësimin nga ana e tyre të stileve të shëndetshme të jetesës dhe aftësive të vetëkujdesit, bazuar në njohuritë dhe aftësitë e fituara sipas paragrafëve (a) dhe (b) të pikës 3;
 - e. të këshillojë, edukojë dhe mbështesë në mënyrë të pavarur individët dhe familjet e tyre që kanë nevojë për fizioterapi;
 - f. të garantojë dhe vlerësojë në mënyrë të pavarur cilësinë e fizioterapisë;
 - g. të komunikojë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe profesionale duke bashkëpunuar me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor;
 - h. të verifikojë cilësinë e terapive të fizioterapisë së ofruar për të përmirësuar praktikën profesionale të fizioterapeutëve.
5. Në lidhje me diagnozën dhe trajtimin mjekësor dhe duke u mbështetur tek kompetencat të tij/saj, fizioterapisti:
- a. përgatit dhe përcakton brenda ekipit multidisciplinor, programin e rehabilitimit, i cili synon identifikimin e nevojës dhe kujdesin për shëndetin e personave me patologji të ndryshme si neurologjike dhe ortopedike;
 - b. realizon në mënyrë të pavarur aktivitetin terapeutik për rikthimin funksional të aftësive të kufizuara motorike, psikomotore dhe njohës i terapive fizike, manuale, masazhore dhe terapive të tjera profesionale;
 - c. propozon adoptimin e protezave dhe mjeteve ndihmëse, trajnon pacientët për t'i përdorur dhe verifikon efektivitetin e tyre;
 - d. verifikon qasjen e metodologjisë së rehabilitimit të përdorur me objektivat e rimëkëmbjes funksionale.
6. Fizioterapeuti kontribuon në trajnimin e stafit mbështetës duke ndikuar drejtpërdrejtë në përditësimin e profilit të tyre profesional dhe kërkimit shkencor.
7. Fizioterapeuti ushtron veprimtarinë e tij profesionale në strukturat shëndetësore publike ose jo-publike

4

Profili profesional i Logopedit në Republikën e Shqipërisë

Me qëllimin për të garantuar mbrojtje të shëndetit të popullatës dhe dhënien e një shërbimi në standarte, domosdoshmërinë e edukimi në vazhdim dhe trajnimet figura profesionale e Logopedistit identifikohet me profilin e mëposhtëm:

1. Logopedi është punonjësi shëndetësor i cili disponon diplomën e nivelin e parë të studimeve të arsimit të lartë (Bachelor), ka kaluar me sukses Provimin e Shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe është i pajisur me Leje të ushtrimit të profesionit nga Urdhri përkatës profesional duke qenë pjesë e regjistrit të anëtarësisë.
2. Logopedi ofron shërbim të përgjithshëm rehabilitimi të patologjive të të folurit dhe komunikimit në moshën pediatrike, adultët dhe moshat geriatrikë.
3. Logopedisti duhet të duhet të zotërojë:
 - a. njohuri profesionale dhe shkencore në të cilat bazohet mjekësia diagnostikuese dhe rehabilituese dhe që lidhen drejtpërdrejtë me praktikën profesionale të tij, njohuri të mjaftueshme rreth shëndetit holistik: fizik, mendor dhe psiko - emocional të individit;
 - b. njohuri për natyrën e profesionit, etikën në punë dhe parimet e përgjithshme të cilat kanë lidhje me mbrojtjen e shëndetit dhe ofrimin e shërbimit mjekësor përkatës;
 - c. të mbështetet në parimin e mosdiskriminimit sidhe mbrojtjen e konfidencialitetit;
 - d. të ruajë sekretin mjekësor;
 - e. përvojë klinike; Një përvojë e tillë duhet të fitohet nëpërmjet praktikës , edukimit në vazhdim dhe mbikëqyrjes nga personeli kompetent i kualifikuar dhe me përvojë në vendet ku numri i personelit dhe prania e pajisjeve të duhura për trajnim është i përshtatshëm për terapinë rehabilituese të logopedit, qofshin këto diagnostikuese apo terapeutike;
 - f. aftësi për të bashkëpunuar me ekipin multidisiplinar, në lidhje me trajnimin praktik të studentëve.
4. Në përputhje me ekspertizën e tij, Logopedi duhet të jetë në gjendje të zbatojë të paktën aftësitë e mëposhtme:
 - a. të menaxhojë në mënyrë të pavarur terapinë e të folurit të përshkruar nga mjeku specialist i kërkuar, duke përdorur njohuritë e tij teorike dhe klinike;
 - b. të planifikojë, organizojë dhe zbatojë ndërhyrjet e tij në trajtimin e pacientëve, bazuar në njohuritë dhe aftësitë e parashikuara në paragrafet (a), (b) dhe (c) të pikës 3, me qëllim përmirësimin e praktikës profesionale;

- c. të punojë në mënyrë efektive me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor, duke qenë bashkëpunues në trajnimin praktik të tyre dhe duke u mbështetur tek njohuritë bazë dhe aftësitë e fituara në përputhje me paragrafët (d) dhe (e) të pikës 3
- d. të fuqizojë individët, familjet dhe grupet në përvetësimin e stileve të shëndetshme të jetesës dhe aftësive të vetëkujdesit, bazuar në njohuritë dhe aftësitë e fituara sipas paragrafeve (a) dhe (b) të pikës 3;
- e. të këshillojë, edukojë dhe mbështesë në mënyrë të pavarur individët që kanë nevojë për logopedist dhe familjarët e tyre;
- f. të garantojë dhe vlerësojë në mënyrë të pavarur cilësinë e terapisë rehabilituese të ofruar prej titë komunikojë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe profesionale duke bashkëpunuar me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor;

5. Veprimtaria e logopedit ka për qëllim vlerësimin dhe trajtimin e të gjitha patologjive që shkaktojnë çrregullime të zërit, gjuhës së folur e të shkruar dhe të meta gjatë komunikimit.

6. Në lidhje me diagnozën dhe përshkrimin e mjekut dhe brenda kompetencave të tij/saj, logopedi:

- a. identifikon dhe vlerëson brenda ekipit multidisiplinar të personave me patologji të ndryshme;
- b. ushtron në mënyrë të pavarur veprimtari terapeutike, duke njohur dëmtimet funksionale, kufizimin e aftësive komunikuese, njohëse, duke përdorur teknikat e të folurit, për të rehabilituar dhe mundësuar komunikimin verbal dhe joverbal;
- c. propozon dhe miraton përdorimin e mjeteve ndihmëse të nevojshme për terapi, i trajnon pacientët për t'i përdorur këto mjete dhe verifikon efektivitetin e tyre;
- d. ushtron veprimtari profesionale studimore, edukuese dhe këshilluese në shërbimet shëndetësore dhe kudo kërkohen aftësitë e tij profesionale;
- e. verifikon përputhjen e metodologjisë së rehabilitimit të zbatuar me objektivat e rimëkëmbjes funksionale.

7. Logopedi ushtron veprimtarinë e tij profesionale në strukturat shëndetësore publike ose jo-publike.

Profili profesional i Teknikut të Imazherisë në Republikën e Shqipërisë

Me qëllimin për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe dhënien e një shërbimi cilësor dhe të mbështetur në standarte, domosdoshmërinë e edukimit në vazhdim dhe të trajnimeve, duke patur në konsideratë rritjen e vazhdueshme të numrit të ekzaminimeve radiologjike të kërkuara , figura profesionale e teknikut të imazherisë të identifikohet me profilin e mëposhtëm:

1. Tekniku i Imazherisë është punonjësi shëndetësor i cili disponon diplomën e nivelin e parë të studimeve (Bachelor), ka kaluar me sukses Provimin e Shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë, si dhe është i pajisur me Leje të ushtrimit të profesionit nga Urdhri përkatës profesional duke qenë pjesë e regjistrit të anëtarësisë.
2. Tekniku i Imazherisë është përgjegjës për të kryer me kompetencë detyrat përkatëse. Gjithashtu është i autorizuar për të kryer ekzaminime, si dhe për përdorimin / mirëmbajtjen e pajisjeve radiologjike qofshinkëto terapeutike ose diagnostikuese.
3. Tekniku i Imazherisë duhet të ketë:
 - a. njohuri shkencore mjekësore brënda fushës së imazherisë;
 - b. njohuri për anatominë, funksionet fiziologjike, sjelljen/qasjen e individëve të shëndetshëm dhe atyre të sëmurë, marrëdhëniet midis gjëndjes shëndetësore, mjedisit fizik dhe atij social të njeriut;
 - c. njohuri për natyrën e profesionit, etikën në punë dhe parimet e përgjithshme të cilat kanë lidhje me mbrojtjen e shëndetit dhe ofrimin e shërbimit mjekësor përkatës; të mbështetet në parimin e mosdiskriminimit sidhe mbrojtjen e konfidencialitetit. Të ruajë sekretin mjekësor.
 - d. përvojë klinike ; Një përvojë e tillë duhet të fitohet nëpërmjet praktikës, e dukimit në vazhdim dhe mbikëqyrjes nga personeli kompetent i kualifikuar dhe me përvojë në vendet ku janë të instaluar pajisjet e nevojshme për realizimin e ekzaminimeve radiologjike, qofshin këto diagnostikuese apo terapeutike.
 - e. aftësi për të bashkëpunuar me ekipin multidisiplinar, në lidhje me trajnimin praktik të studentëve.
4. Në përputhje me ekspertizën e tij, tekniku i imazherisë mjekësore duhet të jetë në gjendje të zbatojë të paktën aftësitë e mëposhtme:
 - a. të menaxhojë në mënyrë të pavarur për marrjen e imazheve diagnostike të përshkruara nga mjeku

specialist, duke përdorur njohuritë teorike dhe klinike, si dhe të planifikojë, organizojë dhe zbatojë procedurat në lidhje me përgatitjen dhe menaxhimin e pacientëve, bazuar në njohuritë dhe aftësitë e mëparshme. Këto çështje janë të parashikuara në paragrafët (a), (b) dhe (c) të pikës 3, dhe kanë si qëllim përmirësimin e punës së tyre praktike profesionale.

b. të punojë në mënyrë efektive me profesionistët e tjerë të kujdesit shëndetësor, duke qenë bashkëpunues në trajnimin praktik të tyre dhe duke përdorur njohuritë bazë të fituara në përputhje me paragrafët (d) dhe (e) të pikës 3;

të informojë pacientët dhe familjarët e tyre në lidhje me procedurat radiologjike diagnostikuese ose radioterapeutike, efektet anësore të mundshme që mund të shfaqen si dhe rreziqet që vijnë si pasojë e tyre;

c. të ketë komunikim profesional dhe gjithëpërfshirës me profesionistët e tjerë të kujdesit shëndetësor;

d. të verifikojë cilësinë e imazheve diagnostike të ofruara, për të përmirësuar praktikën profesionale të teknikëve të imazherisë dhe imazherisë diagnostike në përgjithësi

5. Tekniku i Imazherisë është një punonjës shëndetësor i autorizuar për të kryer në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me profesionistë të tjerë të shëndetit dhe me rekomandim mjekësor, të gjitha procedurat që kërkojnë përdorimin e burimeve të rrezatimit jonizues dhe jojonizues; rrezatimit termik me ultratinguj; rezonancës magnetike, si dhe protokollet bazë për mbrojtjen nga këto forma të rrezatimit si dhe njohuritë bazë dozimetrike, duke u mbështetur mbi protokollet përkatëse të kabinetit ku ushtron detyrën e tij si dhe në rekomandimet e IAEA (Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike).

6. Tekniku i Imazherisë, kontribuon në trajnimin e stafit mbështetës duke ndikuar drejtpërdrejtë në përditësimin e profilit të tyre profesional dhe kërkimit shkencor.

7. Tekniku i Imazherisë ushtron veprimtarinë e tij profesionale në strukturat shëndetësore publike ose jo-publike.

Profili profesional i Teknik Laboratorit në Republikën e Shqipërisë

Me qëllimin për të garantuar mbrojtje të shëndetit të popullatës dhe dhënien e një shërbimi në standarte, dhe duke parë ndryshimet e shpejta dhe zhvillimet në shkencën diagnostike domosdoshmëria e edukimit në vazhdim dhe trajnimeve motivon përmirësimin profesional të teknikeve të laboratorit. Një teknik laboratorit është shtylla e çdo ekipi të kujdesit shëndetësor dhe përfaqëson pikën fillestare për diagnostikimin, zbulimin parandalimin dhe trajtimin e sëmundjes.

Teknik Laboratorit identifikohet me profilin e mëposhtëm:

1. Teknik Laboratorit është punonjësi shëndetësor i cili disponon diplomën e nivelin e parë të studimeve të arsimit të lartë (Bachelor), ka kaluar me sukses Provimin e Shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë, si dhe është i pajisur me Leje të ushtrimit të profesionit nga Urdhri përkatës profesional duke qenë pjesë e regjistrit të anëtarësisë.
2. Tekniku i Laboratorit është figura profesionale që kryen analiza laboratorike dhe veprimtarikërkimore në lidhje me analizat biomjekësore, bioteknologjike dhe në veçanti biokiminë, mikrobiologjinë, virologjinë, farmakotoksikologjinë, imunologjinë, patolog hematologjinë, citologjinë dhe histopatologjinë.
3. Tekniku i Laboratorit duhet të ketë:
 - a. njohurishkencore mjekësore brenda fushës së laboratorit;
 - b. njohuri për anatominë, funksionet fiziologjike, sjelljen/qasjen e individëve të shëndetshëm dhe atyre të sëmurë; marrëdhëniet midis gjëndjes shëndetësore, mjedisit fizik dhe atij social të njeriut;
 - c. njohuri për natyrën e profesionit, etikën në punë dhe parimet e përgjithshme të cilat kanë lidhje me mbrojtjen e shëndetit dhe ofrimin e shërbimit mjekësor përkatës; të mbështetet në parimin e mosdiskriminimit si dhe mbrojtjen e konfidencialitetit. Të ruajë sekretin mjekësor;
 - d. përvojë klinike; Një përvojë e tillë duhet të fitohet nëpërmjet praktikës, edukimit në vazhdim dhe mbikëqyrjes nga personeli kompetent i kualifikuar dhe me përvojë në vendet ku janë të instaluara pajisjet e nevojshme për realizimin e ekzaminimeve laboratorike, mënyrë të përshtatshme përkryerjen e analizave dhe testeve laboratorike;
 - e. aftësi për të bashkëpunuar me ekipin multidisciplinar, në lidhje me trajnimin praktik të studentëve.
4. Në përputhje me ekspertizën e tij, tekniku i laboratorit, gjatë procedurave të testimeve, me rëndësi të

madhe ka precizionin e këtyre testimeve dhe duhet të jetë në gjendje të zbatojë të paktën aftësitë e mëposhtme:

- a.** të menaxhoj në mënyrë autonome analizat e përshkruara nga mjeku specialist i kërkuar, duke përdorur njohuritë aktuale teorike dhe praktike, bazuar në njohuritë dhe aftësitë e parashikuara në pikat (a), (b) dhe (c) të pikës 3 të mëparshme, për të përmirësuar aftësitë profesionale.
- b.** të punojë në mënyrë efektive me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë bashkëpunimin në trajnimin praktik të personelit të kujdesit shëndetësor në bazë të njohurive dhe aftësive të fituara në përputhje me shkronjat (d) dhe (e) të pikës 3 të mëparshme;
- c.** aftësi për të përcaktuar mundësitë tuaja kur merrni vendime ose zgjidhni problemet për të zgjedhur rezultatin me premtues. Të lehtësoj individët, familjet dhe grupet (fuqizimi), përvetësimi i stileve të shëndetshme të jetesës dhe aftësive të vetëkujdesit, bazuar në njohuritë dhe aftësitë e fituara sipas pikave (a) dhe (b) të pikës 3;
- d.** Të këshilloj, edukoj dhe mbështesi në mënyrë të pavarur individët dhe familjet e tyre që kanë nevojë për një asistencë të teknikut të laboratorit;
- e.** Të komunikoj në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe profesionale duke bashkëpunuar me profesionistë tjetër të kujdesit shëndetësor.

5. Tekniku i Laboratorit :

- a.** Kryen detyrat e tij/saj të punës me autonomi teknike dhe profesionale në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me stafin e diplomuar të laboratorit të ngarkuar me përgjegjësitë e ndryshme operacionale të cilave u përkasin;
- b.** është përgjegjës, në strukturat laboratorike, për përmbushjen e saktë të procedurave analitike dhe për punën e tij, në kuadër të funksioneve të tij në zbatimin e protokolleve të punës të përcaktuara nga drejtuesit përgjegjës;
- c.** verifikon korrespondencën e shërbimeve të ofruara me treguesit dhe standardet e paracaktuara nga titullari i strukturës;
- d.** kontrollon dhe verifikon funksionimin e duhur të pajisjeve të përdorura, siguron mirëmbajtjen rutinë dhe eliminimin eventual të problemeve të vogla;
- e.** merr pjesë në planifikimin dhe organizimin e punës brenda strukturës në të cilën vepron;
- f.** ushtron veprimtarinë e tij në struktura laboratorike publike dhe jo-publike, të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi, në marrëdhënie punonjësi ose të pavarur.

6. Tekniku i Laboratorit, kontribuon në trajnimin e stafit mbështetës duke ndikuar drejtpërdrejtë në përditësimin e profilit të tyre profesional dhe kërkimit shkencor.

7. Tekniku i Laboratorit ushtron veprimtarinë e tij profesionale në strukturat shëndetësore publike ose jo-publike.

Profili profesional i Teknikut të Laboratorit Dentar në Republikën e Shqipërisë

Me qëllimin për të garantuar mbrojtje të shëndetit të popullatës në përgjithësi dhe të shëndetit oral në veçanti, dhënien e një shërbimi në standarte, domosdoshmëria e edukimit në vazhdim dhe trajnimeve, figura profesionale e Teknikut të Laboratorit Dentar identifikohet me profilin e mëposhtëm:

1. Tekniku i Laboratorit Dentar është punonjësi shëndetësor i cili disponon diplomën e nivelin e parë të studimeve të arsimit të lartë (Bachelor), është i pajisur me Leje të ushtrimit të profesionit nga Urdhri përkatës profesional duke qenë pjesë e regjistrit të anëtarësisë.
2. Tekniku i Laboratorit Dentar është figura profesionale pjesëtar i ekipit dentar që realizon dhe riparon mjete protetike dentare të ndyshme për rehabilitimin oral, në mungesë të pjesshme apo të plotë të dhëmbëve, sikurse edhe aparate për trajtimin ortodontik, të bëra me porosi, sipas përshkrimit të stomatologut.
3. Tekniku i Laboratorit Dentar duhet të ketë njohuri të punimeve laboratorike dentare, në:
 - a. proteza fikse - të tilla si inley, onley, implante, kurora dhe ura të realizuara me metal, porcelan, zirkon;
 - b. proteza të lëvizshme - siç janë protezat totale dhe protezat parciale të lëvizshme;
 - c. proteza maksilofaciale – pajisje / mjete protetike për rikuperimin e tërësisë anatomike të indevetë buta e të forta të fytyrës, të dëmtuara nga një sëmundje ose një aksident, siç janë shinat kirurgjikale, obturatorët, protezat kirurgjikale, epitezat e fytyrës, etj; ortodoncia – pajisje ortodontike fikse, ose të lëvizshme për drejtimin e dhëmbëve dhe apo për parandalimin eshfaqjes së parregullsive dentoalveolare.
4. Tekniku i Laboratorit Dentar është përgjegjës për cilësinë dhe saktësinë e punimeve laboratorike dentare të bëra me porosi, sipas specifikimeve të detajuara në recetën e dhënë nga stomatologu, i cili është i vetmipërgjegjës për diagnostikimin, planifikimin apo trajtimin e pacientëve.
5. Në përputhje me ekspertizën e tij, Tekniku i Laboratorit Dentar duhet të jetë në gjendje të zbatojë të paktën aftësitë e mëposhtme :
 - a. marrjen e porosive nga stomatologu në lidhje me nevojat e pacientëve për një punim laboratorik;
 - b. konsultimin me stomatologun rreth specifikimeve dhe modeleve për të përcaktuar dizajnin

e një punimi laboratorik;

- c. kryerjen e aktiviteteve, fabrikimi, ndryshimi dhe riparimi në punimet laboratorike dentare si kurora, proteza dhe ura, të tilla si: përzien allçinë për realizimin e modeleve, përgatit lugët individuale për marrjen e masës (gjurmëve) dentare, modelon formën dhe pamjen e punimit me dyllë mbi modelet e punës, shkrin dhe derdh aliazhe metali për bazat e protezave fikse, përgatit dhe përpunon lëndën metilmetakilat për të realizuar proteza dentare të lëvizshme dhe aparate ortodontike, përpunon mekanikisht e kimikisht punimet e derdhura, modelon në porcelan punimet fikse, lakon tela dhe prodhon aparate ortodontike fikse dhe të lëvizshme për të korrigjuar parregullsitë apo anomalitë dentare, si edhe proteza maksilo - faciale për pacientët që kanë pasur lëndime të fytyrës, disenjon në CAD-CAM, fabrikon dhe rregullon implantet dentare, riparon punimet laboratorike dentare të dëmtuara;
- d. krijimin dhe mirëmban një inventar të pajisjeve dhe furnizimeve të laboratorit dentar;
- e. inspektimin e pajisjeve dentare për nevoja riparimi, mirëmbajtjeje ose zëvendësimi, për t'u siguruar që ato janë në gjendje pune dhe në përputhje me specifikimet e përdorimit.

6. Kompetencat e teknikut dentar në punën në ekip kur trajtimi dentar përfshin bashkëpunimin midis stomatologut dhe teknikut dentar me qëllim të ofrimit të kujdesit më të mirë të mundshëm të shëndetit oral për popullatën, stomatologu duhet të përdorë shërbimet e një teknikut dentar të diplomuar e të kualifikuar.

7. Tekniku i Laboratorit Dentar duhet të:

- a. ushtrojë profesionin brenda kufijve të fushës së punës së Teknikut të Laboratorit Dentar, siç përcaktohet me ligj dhe rregullore;
- b. t'i nënshtrohet zhvillimit profesional të vazhdueshëm, duke përfshirë njohuritë e përditësuara të kontrollit të infeksionit;
- c. të pranojë dhe ndjekë recetat, udhëzimet dhe specifikimet e materialeve të dhëna nga stomatologu;
- d. të komunikojë me stomatologun në lidhje me teknikat, materialet dhe procedurat alternative ose të reja;
- e. të sigurojë përdorimin vetëm të produkteve dhe metodave të certifikuara për një shërbim të standardit të lartë në përputhje me udhëzimet e dhëna nga prodhuesit e materialeve të përdorura në fabrikimin e pajisjeve dentare;
- f. të marrë përsipër përgjegjësitë ligjore për punën brenda laboratorit dentar;
- g. t'i sigurojë stomatologut të gjithë informacionin e nevojshëm për punën laboratorike të kryer, duke përfshirë të gjitha materialet e përdorura;
- h. të mbrojnë të gjitha të dhënat duke përfshirë të dhënat personale të pacientit dhe pajisjet e tij/sajdentare.

8. Tekniku i Laboratorit Dentar ushtron veprimtarinë e tij/saj profesionale në strukturat shëndetësore publike ose jo-publike.